

VENDIM
Nr.335, datë 25.3.2008

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE, TË SHKAKTUARA
NGA TRAGJEDIA E DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare familjeve të viktimave, që kanë humbur jetën në tragjedinë e datës 15.3.2008, si pasojë e aksidentit teknologjik në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë për çdo pjesëtar, që ka humbur jetën.
2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi
- 3 Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha